

# Kodi i Sjelljes së Furnitorit në World Vision

Përditësuar për herë të fundit në qershor 2021

Versioni 2.0

World Vision është një organizatë e krishterë humanitare, zhvillimi dhe mbështetjeje, e përkushtuar ndaj punës me fëmijët, familjet dhe komunitetet për të mposhtur varfërinë dhe padrejtësinë. Të frymëzuar nga vlerat tona të krishtera, jemi përkushtuar ndaj të punuarit me njerëzit më në nevojë në botë. Ne u shërbejmë të gjithëve pa dallim feje, race, kombësie apo gjinie.

World Vision është angazhuar fuqishëm të respektojë standardet më të larta etike dhe morale në të gjitha veprimtaritë e saj të prokurimit përfshirë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve në programet e saj. Ky Kod Sjelljeje përcakton një sërë parimesh dhe sjelljesh që duhet të na drejtojnë në sjelljen tonë të përditshme në punë me një etikë prokurimi të njohur ndërkombëtarisht. Elementet standarde të praktikës së mirë të biznesit duhen zbatuar gjithashtu. Kodi i Sjelljes aplikohet nga personeli i të gjitha zyrave të World Vision dhe Vision Fund (WV/VF) dhe shtrihet edhe te furnitorët, kontraktorët, vullnetarët dhe Anëtarët e Bordit. Për t'u siguruar që pritshmëritë e donatorëve të WV/VF të dëgjohen, ne u përmbahemi kërkesave të tyre në prokurim, aty ku është e mundur. Furnitorët dhe nënkontraktorët e tyre, duhet të nënshkruajnë Kodin e Sjelljes, që konfirmon pajtimin e tyre për të vepruar në përputhje me parimet e shprehura këtu.

## **WV/VF kërkon që furnitorët e saj:**

- 1) T'i përdorin fondet me efektshmërinë më të madhe-
  - a) Të përpiqen në mënyrë aktive të demonstrojnë dhe përmirësojnë rezultatet si edhe të ulin shpenzimet gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjeve Afatgjata dhe/ose Porosive për Blerje.
  - b) Të vlerësojnë në mënyrën e duhur dhe me ndershmëri që të pasqyrohen kërkesat dhe rreziqet.
  - c) Të synojnë në mënyrë proaktive përmirësimin vazhdueshëm të pakësimit të mbetjeve dhe të përmirësojnë efektshmërinë e mbarë organizatës dhe zinxhirit të furnizimit më gjerë.
  - d) Të nxjerrin fitime të drejta pa teprime.
- 2) Të veprojnë me Profesionalizëm dhe integritet –
  - a) Të tregohen të ndershëm dhe realistë përsa i përket kapacitetit dhe aftësisë së tyre kur bëjnë oferta.
  - b) World Vision kërkon që furnitorët e saj të inkurajojnë dhe punojnë me furnitorët dhe nënkontraktorët e tyre për t'u siguruar që parimet e këtij Kodi Sjelljeje të përmbushen dhe të jenë në gjendje ta vërtetojnë këtë kur dhe si t'u kërkohet.
  - c) Të punojnë së bashku për të ngritur marrëdhënie biznesi profesionale, duke përfshirë personelin e World Vision.
  - d) Të veprojnë në funksion të përkrahjes së zhvillimit të një marrëdhënieje biznesi të pjekur dhe etike me World Vision.
  - e) Të shfaqin përkushtim të qartë dhe aktiv ndaj Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës.
  - f) Të jenë të pastër ndaj çdo akuze ligjore të depozituar në gjykatë gjatë tre viteve të fundit.
- 3) Të jenë të përgjegjshëm –
  - a) Të krijojnë struktura vlerësimi që harmonizojnë pagesat me rezultatet dhe pasqyrojnë një ndarje të ekuilibruar të rrezikut nga performanca.
  - b) Të jenë të gatshëm të japin llogari për dorëzimin e shërbimit dhe të pranojnë përgjegjësitë e tyre, duke u treguar të ndershëm kur gjërat shkojnë keq në mënyrë që të nxirren mësim.
- 4) Të pajtohen me parimet e WV/VF-së–
  - a) T'i mësojnë ngritjes së kapaciteteve lokale nëpërmjet gjetjes së mënyrave për të zhvilluar tregjet dhe institucionet vendase dhe të shmangin përdorimin e marrëveshjeve ekskluzive dhe kufizuese.
  - b) Të jenë në gjendje të veprojnë në të gjitha zyrat e World Vision, përfshirë zonat delikate dhe të prekura nga konfliktet.
  - c) Të ndajnë dhe transferojnë risitë dhe njohuritë për praktikat më të mira që të rritet sa më shumë ndikimi i zhvillimit të përgjithshëm.

- d) Të pranojnë që WV/VF punojnë në mjedise sfiduese dhe të veprojnë për të menaxhuar pasiguritë dhe të ndryshojnë në mënyrë të atillë që të mbrohet efektshmëria e shpenzimeve.
  - e) Të pasqyrojnë objektivat ndërkombëtare të zhvillimit të WV/VF-së dhe të angazhohen për uljen e varfërisë.
- 5) Të pranojnë shmangien e çdo Konflikti Interesi—  
Për shmangien e konflikteve të interesit, Furnitorët ose kontraktorët pranojnë dhe deklarojnë tek WV sa më poshtë:
- a) nëse Furnitori ose Kontraktori ose një i afërm i Furnitorit ose Kontraktorit, marrin përfitime financiare nga WV/VF. (Kjo përfshin të shërbyerit si punonjës, agjent ose kontraktor i pavarur i WV/VF-së).
  - b) nëse Furnitori ose Kontraktori ka marrëdhënie ekzistuese biznesi me WV/VF. (Kjo përfshin të qenit konsulent, ofrues shërbimi ose furnitor për WV/VF.)
  - c) nëse Furnitori ose Kontraktori ka marrëdhënie biznesi ose familjare (jashtë zyrës së WV/VF) me një anëtar të WVI-së or bordit të VFI-së ose një anëtar të ekipit të menaxhimit të lartë të WVI-së ose VFI-së.

Për më tepër, Furnitori ose Kontraktori konfirmon se nuk kanë asnjë marrëdhënie, filial biznesi, përfshirje, lidhje, pozicion pune, interes financiar dhe nuk kanë përfituar asnjë dhuratë, kredi apo të jenë angazhuar në ndonjë transaksion tjetër e cila kërkon deklarimin e konfliktit të interesit sipas Politikës së Konfliktit të Interesit të World Vision ose VisionFund.

- 6) Të zbatojnë Konventat Ndërkombëtare të Punës –
- a) World Vision kërkon që furnitorët e saj, si dhe nënkontraktorët e tyre, të zbatojnë Konventat Ndërkombëtare të Punës.
  - b) Të ndalojnë përdorimin e çdo pune të detyruar, skllavëruese, apo angari, apo punë të detyruar të dënuarish.
  - c) Të ndalojnë përdorimin e punës së fëmijëve.
  - d) Të ndalojnë çdo formë diskriminimi në praktikat e punësimit për shkak të racës, ngjyrës, fesë, gjinisë, kombësisë, moshës, apo paafësive fizike.
  - e) Të respektojnë ligjet vendore për sa u përket pagave, orëve të punës, lirisë së shoqërimit dhe të drejtës për t'u organizuar dhe për të negociuar në mënyrë kolektive.
  - f) Të mbështesin dhe respektojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të sigurohen që të mos bëhen bashkëpunëtorë për shkeljen e të drejtave të njeriut.
  - g) Të marrin masa që vendet e tyre të punës dhe çdo vend tjetër ku realizohet prodhimi ose puna të jenë të sigurta dhe të shëndetshme.
- 7) Të respektojnë Politikën e Ruajtjes së Fëmijës dhe të Rriturit të WV-së -
- a) Furnitorët ose Kontraktorët të angazhuar në situata ku ata—ose punonjës të tyre apo nënkontraktorë—mund të kenë akses te fëmijët apo të rriturit përfitues nga programet e WV-së ose të dhënave personale të këtyre fëmijëve ose të rriturve përfitues, duhet të respektojnë Protokollin e Sjelljes Ruajtëse (shihni faqe 4 më poshtë).
  - b) Çdo incident që dëmton ose rrezikon të dëmtojë fëmijët ose të rriturit përfitues do të raportohet menjëherë tek WV-ja.
  - c) Çdo individ me akses te fëmijët ose të rriturit përfitues, ose te të dhënat personale të këtyre personave, duhet të ketë një të shkuar të pastër kriminale në lidhje me shkeljet ose abuzimet ndaj të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve, në masën e lejuar nga ligji (prova të së cilës do t'i sigurohen WV-së sipas kërkesës).
- 8) Të kenë një Politikë të fortë Mjedisore—
- a) World Vision kërkon prej furnitorëve të saj zbatimin e një politike efikase për mbrojtjen e mjedisit dhe dhe të zbatojnë legjislacionin dhe rregullat ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit.
  - b) Furnitorët priten të ndërmarrin iniciativa për nxitjen e përgjegjësisë më të madhe mjedisore dhe për përdorimin e teknologjive miqësore ndaj mjedisit.
  - c) Furnitorët duhet të sigurojnë, kudo që të jetë e mundur, një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë.

- 9) Antikorrupsioni dhe Mitmarrja—

- a) World Vision kërkon që furnitorët e saj të zbatojnë standardet më të larta morale dhe etike, përfshirë zhvatjen, mashtrimin dhe ryshfetin.
- b) Të mos bëjnë asnjë tolerim ndaj korrupsionit dhe mashtrimit, me një menaxhim rreziku të cilësisë më të lartë.
- c) Të informojnë për çdo situatë që mund të duket si konflikt interesi. Plotësoni formularin e deklarimit të konfliktit në faqen 3 më poshtë.
- d) Të bien dakord për kontrolle të hollësishme të gjendjes gjyqësore dhe të së shkuarës së tyre kriminale

**LETËR MBI DEKLARIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT**  
**Formulari standard i World Vision, përmirësuar për Furnitorët**  
**--varianti i shkurtit 2020--**

Pasi kam lexuar Kodin e Sjelljes së WorldVision (WV) dhe kam shqyrtuar marrëdhëniet e mia me World Vision ose Vision Fund (VF), si dhe duke theksuar se nëse kam dyshime mbi një marrëdhënie do ta deklaroj për diskutim të mëtejshëm, shqyrtova me kujdes secilin prej katër pohimeve të mëposhtme dhe kam shënuar “po” ose “jo” për secilin.

Vini re se “WV/VF” sikurse përdoret më poshtë i referohet çdo njësie ekonomike/enti të World Vision ose VisionFund përfshirë dhe institucionet mikrofinanciare. Termi “I afërm” i referohet çdo lidhjeje gjaku apo martesë individuale. Qarkoni përgjigjen e duhur për secilin nga pohimet e mëposhtme:

- 1. Po / Jo Unë/kompania/biznesi im (ose një i afërm i imi merr përfitime financiare nga WV/VF-ja. (Kjo përfshin edhe të shërbyerit si vullnetar ose të qenit përfitues i WV/VF-së). [Nëse përgjigja është po, ju lutemi paraqisni hollësi në fund të këtij formulari.]
- 2. Po / Jo Unë, ose një i afërm i imi, jam aktualisht punonjës i WV/VF-së. [Nëse përgjigja është po, ju lutemi paraqisni hollësi në fund të këtij formulari.]
- 3. Po / Jo Unë/kompania ime (ose një i afërm i imi) ka marrëveshje ekzistuese biznesi me WV/VF-në. (Kjo përfshin gjëra të tilla si të qenit një konsulent, ofruer shërbimi ose një furnitor për WV/VF-në) [Nëse përgjigja është po, ju lutemi paraqisni hollësi në fund të këtij formulari.]
- 4. Po / Jo Unë/kompania ime ka një marrëdhënie biznesi ose familjare (jashtë WV/VF-së) me një anëtar të bordit të WVI-së ose VFI-së, ose me një anëtar të ekipit drejtues të lartë të WVI-së ose VFI-së. [Nëse përgjigja është po, ju lutemi paraqisni hollësi në fund të këtij formulari.]

Ju lutemi përshkruani si më poshtë detajet e çdo përgjigjeje pozitive për pikat 1 – 4 më sipër dhe/ose çdo konflikt interesi të mundshëm, ose çdo koment që do të dëshironit të bëni për çështje të deklaruara si më sipër. Nëse keni nevojë për më shumë hapësirë, ju lutemi të bashkëngjisni një letër shtesë.

---



---



---



---



---



---



---



---

- Klikoni mbi këtë kuti nëse pajtoheni me deklaratën: Unë vërtetoj që përgjigjet e mia për pohimet I - 4 më lart janë të sakta. Nëse kam zgjedhur “jo” për të gjitha deklaratat I - 4, konfirmoj se nuk kam marrëdhënie, lidhje biznesi, përfshirje, bashkëpunime, pozicione, interesa financiare, dhurata, hua ose transaksione të tjera që kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese nën Politikën e Konfliktit të Interesit të Word Vision ose VisionFund.

## PROKOLLI I SJELLJES PËR RUAJTJEN E FËMIJËVE DHE TË RRIURVE

Mbrojtja e fëmijëve dhe të rriturve në nevojë në programet e World Vision është thelbësore për të gjitha aspektet e punës sonë. Një element thelbësor i gjithçkaje që bëjmë është angazhimi ynë për të mos dëmtuar fëmijët dhe të rriturit përfitues të programeve WV, respektimin e të drejtave të tyre dhe mbrojtjen e interesave të tyre më të mira si një arsye madhore në çdo veprim dhe vendim.

Prandaj, Furnitorët dhe/ose Bashkëpunëtorët dhe stafi i tyre (p.sh. partnerë, furnitorë, kontraktues, konsulentë dhe/ose vullnetarë të World Vision), do të sillen në mënyra që mbrojnë fëmijët ose përfituesit e rritur, parandalojnë shfrytëzimin dhe abuzimin seksual dhe parandalojnë çdo dëm tjetër të qëllimshëm ose të paqëllimshëm ndaj njerëzve që WV-ja u shërben ose me të cilët punon.

Të gjithë Furnitorët dhe Bashkëpunëtorët i respektojnë këto protokolle për aktivitetet e tyre me WV-në, për të gjithë fëmijët kudo që ndodhen dhe për të gjithë përfituesit e rritur. Në lidhje me mbrojtjen, WV-ja përdor një përkufizim të gjerë të termit 'përfitues' për të përfshirë, jo vetëm përfituesit e drejtpërdrejtë të një projekti të caktuar, por edhe çdo fëmijë apo të rritur që mund të lëndohet nga dëme të shkaktuara nga furnitorët ose bashkëpunëtorët, si pjesë e marrëdhënies së biznesit me WV-në aty ku WV-ja është i pranishëm me programin e saj.

### **Sjellje e Pranueshme - Furnitorët dhe Bashkëpunëtorët (dhe stafi i tyre):**

- a) krijojnë dhe sigurojnë një ambient i cili parandalon shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve dhe të rriturve përfitues dhe promovon zbatimin e këtyre Protokolleve të Sjelljes.
- b) janë të kujdesshëm për perceptime dhe paraqitjen e tyre me gjuhën, veprimet dhe marrëdhënien me fëmijët dhe përfituesit në nevojë. Sjellja e tyre –përfshirë praninë e tyre fizike ose në platforma dixhitale, qoftë online dhe offline – tregon respekt për fëmijët dhe të rriturit përfitues dhe të drejtat e tyre;
- c) sigurohen që të gjitha kontaktet fizike dhe nëpërmjet internetit me fëmijët dhe përfituesit përshtaten me kulturën vendase;
- d) përdorin metoda pozitive, jo të dhunshme për të menaxhuar sjelljen e fëmijëve;
- e) pranojnë përgjegjësinë për sjellje dhe veprime personale si përfaqësues të organizatës
- f) janë gjithmonë të përgjegjshëm për përgjigjet e tyre ndaj sjelljes së një fëmije, edhe kur një fëmijë sillet në një mënyrë seksualisht të papërshtatshme; të rriturit shmangin vendosjen e tyre një pozitë kompromentuese ose vulnerabël
- g) me fëmijët;
- h) ku është e mundur dhe praktike, ndjekin rregullin e 'dy të rriturve' gjatë kryerjes së punës për WV-në, ku dy ose më shumë të rritur mbikëqyrin të gjitha aktivitetet që përfshijnë fëmijët dhe janë të dukshëm dhe të pranishëm në çdo kohë.
- i) pajtohen me hetime (të brendshme dhe të jashtme)që lidhen me mbrojtjen dhe vënë në dispozicion çdo informacion dokumentar apo të një lloji tjetër të rëndësishëm për përfundimin e hetimit.
- j) pajtohen me legjislacionin e aplikuar për ruajtjen e të dhënave dhe me politikat përkatëse të ruajtjes së të dhënave dhe sigurisë së informacionit të WV-së, duke përfshirë protokollin e mbrojtjes dixhitale të fëmijës së WV-së, kur trajtohet çdo e dhënë personale e individëve fëmijë ose të rritur si përfitues, duke theksuar faktin se mbledhja ose përdorimi i këtyre të dhënave duhet të jetë i kufizuar në një minimum të nevojshëm dhe se këto të dhëna duhet të ruhen dhe transferohen në një mënyrë të sigurtë, konfidenciale;
- k) raportojnë menjëherë nëpërmjet mekanizmave të raportimit çdo incident ose shkelje të kësaj Politike lidhur me ruajtjen, të dyshuar ose që ka dijeni një punonjës ose bashkëpunëtor i WV-së, ose një punëtor i ndihmës humanitare nga ndonjë agjenci tjetër. 'Punonjës i ndihmës humanitare' përfshin të gjithë punonjësit, vullnetarët, kontraktorët e paguar dhe bashkëpunëtorë të tjerë të

organizatave që ofrojnë ndihmë emergjence ose ndihmë për zhvillim. Këto organizata përfshijnë agjencitë e UN-së, INGO-të, LNGO-të, and CBO-të.

**Sjellje e Papranueshme – Furnitorët dhe Bashkëpunëtorët (dhe stafi i tyre) nuk:**

- a) sillen në një mënyrë të përshtatshme fizike ose zhvillojnë një marrëdhënie seksuale me një fëmijë (nën moshën 18 vjeç), pavarësisht moshës ligjore madhore të një vendi specifik. Kjo përfshin, gjithashtu, pëlqimin apo tolerimin e sjelljeve të mësipërme (përfshirë strehimin apo tolerimin e martesave me fëmijë (nën moshën 18 vjeç);
- b) zhvillojnë ose kërkojnë marrëdhënie seksuale me përfitues të çdo moshe; këto marrëdhënie nuk janë të pranueshme dhe nuk do të tolerohen pasi bazohen në dinamika pushtetesh krejtësisht të pabarabarta. Këto marrëdhënie ulin besueshmërinë dhe integritetin e ndihmës humanitare apo punës së zhvillimit të WV-së;
- c) shfrytëzojnë apo abuzojnë seksualisht përfitues (të rritur ose fëmijë); kjo sjellje përbën një shkelje madhore;
- d) shkëmbimi i parave, punësimit, mallrave ose shërbimeve për seks, (përfshirë favoret seksuale ose forma të tjera të sjelljeve poshtëruese, degraduese, shfrytëzuese ose punësimitin e punëtorëve të seksit) ose kërkesa të tjera shfrytëzuese, është kategorikisht e ndaluar. Kjo përfshin dhënien e ndihmës e cila u mundësohet tashmë përfituesve;
- e) përkëdheljen, mbajtjen, puthjen, përqafimin ose prekjen e fëmijëve apo të rriturve përfitues në një mënyrë të papërshtatshme ose kulturalisht të papërshtatshme;
- f) përdorimi i gjuhës, sugjerimet ose këshillime të papërshtatshme ose abuzive një fëmije ose të rriturit përfitues, përfshirë gjuhën turpëruese, poshtëruese, përçmuese ose degraduese.
- g) shpenzimi i tepërt ose i panevojshëm i kohës vetëm me fëmijën ose të rriturin përfitues, larg nga prania e të tjerëve ose me dyer të mbyllura apo në një zonë të izoluar.
- h) tolerimi ose marrja pjesë në sjellje të paligjshme, të pasigurta apo abuzive me fëmijë apo të rritur përfitues; përfshirë praktika tradicionale të dëmshme, abuzimin shpirtëror ose ritual;
- i) punësimi i fëmijëve në çfarëdo formë punësimi (duke i përfshirë si “ndihmë për punët e shtëpisë”) nëse kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës dhe në përputhje me ligjin vendas dhe standardet ndërkombëtare (‘Punësimi i fëmijëve’ është punë e cila është mendërisht, fizikisht, shoqërisht ose moralisht e rrezikshme dhe e dëmshme për fëmijët ose që ndërhyr në shkollimin e tyre. ‘Punësimi i fëmijëve’ përkundrazi mund të ketë përfitime nëse lejohet nga Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punësimit (ONP) dhe vë interesat e fëmijës përtej çdo përfitimi të marrë nga të rriturit;
- j) goditja ose përdorimi i dënimeve të tjera fizike ndaj një fëmije ndërkohë që fëmija është nën kujdesin e WV-së ose punonjësi apo bashkëpunëtori i WV-së po kryen punën e WV-së.
- k) marrja e një fëmijë pa shoqërues në një automjet për punë të WV-së, përveçse nëse është absolutisht e nevojshme me miratim të prindit/kujdestarit dhe menaxherit.
- l) keqpërdorim ose shkujdesje me të dhënat personale të fëmijëve dhe të rriturve përfitues;
- m) komunikim me një fëmijë të programit të WV-së nëpërmjet platformave digjitale (p.sh. Facebook, Twitter) nëpërmjet teknologjisë celulare (p.sh. dërgojnë mesazhe në Whatsapp, Skype) ose në internet pa miratimin dhe dijeninë e prindërve të tij/saj. Veç këtyre, punonjësit ose bashkëpunëtorët e WV-së asnjëherë nuk duhet të komunikojnë nëpërmjet platformave celulare, digjitale ose online me fëmijët apo të rriturit përfitues në mënyra të papërshtatshme apo seksuale;
- n) heshtin, mbulojnë, ose mundësojnë çdo incident të dyshuar apo për të cilën kanë dijeni mbi ruajtjen ose shkelin Politikën e Ruajtjes nga një punonjës ose bashkëpunëtor i WV-së.

Klikoni mbi këtë kuti nëse pajtoheni me deklaratën: Unë e kam lexuar, e kam kuptuar plotësisht dhe jam dakord që të zbatoj Protokollin e Ruajtjes së Sjelljes së Fëmijës dhe të Rriturve të World Vision më sipër.

## Deklarata e Njohjes së Kodit të Sjelljes së Furnitorit të WV-së

Nënshkrimi im më poshtë konfirmon se unë/ne/furnitori, kemi lexuar, kemi kuptuar plotësisht dhe jemi dakord të zbatojmë parimet e Kodit të Sjelljes së Furnitorit të WV-së të paraqitura më sipër dhe autorizon WV-në të ndërmarrë verifikime të së shkuarës sipas rastit. Unë e kuptoj se çdo veprim në kundërshtim me këtë Kod Sjelljeje të Furnitorit, përfshirë mungesën e ndërmarrjes së një veprimi të caktuar nga këto protokolle mund të rezultojë në përfundimin e marrëdhënies së biznesit me World Vision.

\_\_\_\_\_  
Emri i printuar dhe Titulli i Përfaqësuesit të  
Furnitorit

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri i Shoqërisë/ Furnitorit

\_\_\_\_\_  
Datë

\_\_\_\_\_  
Emri i printuar dhe Titulli i Përfaqësuesit të  
Furnitorit

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri i Shoqërisë/ Furnitorit

\_\_\_\_\_  
Datë